

**STATUT  
PER  
SHOQERINE  
"ECONNECT AL" SH.P.K.  
(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)**

Në bazë të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" une i nënshkruari shpall si më poshtë vijon:

**Neni 1**

**FORMIMI I SHOQËRISË**

Formohet shoqëria e quajtur **"ECONNECT AL" SH.P.K.** (Qe ketu e me poshte referuar si "Shoqeria"), e cila themelohet nga 1 (një) Ortak i vetem me 100% te kontributeve si me poshte :

**Z. Fatos Xhemajli**, i biri i Fehmi Xhemajlit, lindur në Prishtinë më 22.02.1984, shtetas kosovar e banues ne Prishtinë, mbajtës i ID me numer personal 1030871258, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, ortak me 100% te kontributeve, baras me 100.000 leke.

**Neni 2**

**QENDRA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresen: Rr. "Ruga e Kosovareve", Pall. "Melroz 3", Ap. 5/ Kati i pare, Tirane, Shqiperi.

Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashtë territorit te vendit.



### Neni 3

## KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

Shoqeria mund te perfundoje, te vihet ne likujdim perpara ketij afati ose mund te zgjase aktivitetin e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve.

### Neni 4

## OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

**Aktivitete të menaxhimit të instalimeve informatike dhe shembim konsulence te sistemeve te sigurise dhe IT-së, ne te gjitha llojet dhe format e veta ne sektorin publik dhe ate privat.**

- Ajo do te ushtroj veprimtari edhe ne fushat e meposhtme:
  1. Importimin dhe eksportimin, prodhimin, perpunimin, transformimin dhe tregtimin e te gjitha mallrave e materialeve te lidhura direkt ose indirekt me objektin kryesor dhe paisjeve te ndryshme te konsumit, paisjeve elektronike, materialeve te ndertimit dhe mallrave ushqimore.
  2. Ngritje rrjeti e sistemi programimi, menaxhimi dhe sisteme te tjera mbeshtetese te sigurise dhe IT-së.
  3. Shoqeria ka te drejte te ushtroj aktivitetet ne fushen e shit-blerjes se pasurive te paluajteshme duke u pajisur me licensat e nevojshme per kete qellim nga organet kompetente.
  4. Shoqeria mund te blej, te hyjë ne marredhenie *leasing* dhe te marr apo te jap me qira terrene, impiante dhe uzina, mund kryej, pervec aktiviteve tregtare edhe aktivitete si industriale ashtu edhe bujqesore.
  5. Shoqeria mund te kryeje cdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajteshme dhe te paluajteshme, financiare dhe kreditore si edhe te blej apo shes apo te marr apo jap me qera pasuri, si edhe te kete interesa apo pjesemarrje ne shoqeri, ente, konsorciume, te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane nje objekt te ngjashem apo funksional ne arritjen e qellimeve te Shoqerise, si dhe te ofroje garanci, te marre hua dhe te ofroje garanci, pasurore apo personale, ne favor te te treteve. Ne per gjithesi, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te saj.
  6. Pritje, akomodim me te gjithe llogjistikene e nevojshme per delegacione te huaja per te gjitha aktivitetet qe ata do te kryejne ne Republiken e Shqiperise.

7. Blerje, shitje makinash te ndryshme.

### Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Ortakeve sipas legjislacionit ne fuqi.

### Neni 6

#### KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestar i shoqerise është 100.000 (njeqind mijë) lekë dhe i ndarë në kuota me te njëjtën vlerë por asnjëherë më e vogël se 1.000 (njëmijë) lekë. Kapitali perbehet nga 1(një) kuotë dhe zotërohet 100% nga:

- Ortaku i vetem i shoqerise **Z. Fatos Xhemajli**, mbajtes i ID me numer personal 1030871258, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar **me 1 (një) kuotë baraz me 100%**.

Ortaku mund te vendosi te rrisi kapitalin e shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te asamblese se ortakeve sa here qe shoqeria te kete nevoje per tu mbuluar finanziarisht per zhvillimin normal te aktivitetit te saj kur ajo te kete te papaguar furnitore etj mungesa te likujditetit ose dhe me kontribut ne natyre.

Detyrimet e ortakut kundrejt shoqerise do te mbulohen vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij. Ortaku nuk do te kete asnje perjegjesi tjeter per detyrime te tjera te shoqerise.

Shoqeria nuk perggjigjet per detyrime te marra nga administratori per qellime qe nuk perputhen me ato te paracaktuara nga ky Statut, si edhe per detyrime te marra nga Ortaku ne emrin e tij personal.



## Neni 7

### REGJISTRIMI I SHOQERISE

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB), sipas nenit 43 te ligjit 9723 date 03.05.2007.

## Neni 8

### KALIMI I KUOTAVE DHE E DREJTA E PARABLERJES

Kuotat e kapitalit te shoqerise si dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne cash dhe ne natyre ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes se kuotave
- c) trashegimise
- d) dhurimit
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe fiton ate per gjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit.

- Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen te treteve teresisht ose pjeserisht, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve
- Transferimi per cfaredo arsyje, teresisht ose pjeserisht i pjeseve te kapitalit te Shoqerise eshte subjekt i se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere, te cilet mund te ushtrojne kete te drejte ne raport me pjeset e tyre te kapitalit, brenda 30 (tridhjete) ditesh nga marrja e njoftimit te derguar me leter rekomandim. Ne kete njoftim duhet te saktesohet cmimi i kerkuar, i cili duhet te jete i arsyeshem dhe i njejte me ate qe do ti ofrohet nje personi te trete, jashte shoqerise. Ne rast se ortaket e tjere nuk per gjigjen brenda afatit te parashikuar, konsiderohet se ata kane hequr dore nga ushtrimi i te drejtes se parablerjes.
- Te gjitha njoftimet e siperpermendura do te behen me shkrim dhe i adresohen Administratorit te Shoqerise.

### **Neni 9**

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emri i administratorit, duhet te permenden ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoperi dhe që ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

### **Neni 10**

Shoqeria vepron nen regjin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore.

Organet e shoqerise jane:

- 1- Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë
- 2- 1 (një) Administrator

### **Neni 11**

## **KOMPETENCAT E ORTAKUT TE SHOQERISE**

Per menyren e drejimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, Asambleja e Ortakeve shprehet me vendime per gjithçka qe eshte ne kompetencat e saj te pershkruara si me poshte:

- Ka te dreje te beje ndryshime ne statut.
- Percakton politikat tregtare te shoqerise.
- Ka të drejtë të miratojë bilancin e shoqerise dhe te bej ndarjen e fitimit.
- Ai emeron ose shkarkon administratoret, likujduesit, ekspertet kontabel te autorizuar.
- Mbikeqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miratimin e pasqyrave vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Miraton rritjen ose zvogelimin e kapitalit.
- Percakton shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.
- Miraton pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.



- I jep autorizimin Administratorit ta perfaqesoj shoqerine ne gjykate, kryen riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Miraton rregullat procedurale te mbledhjeve te asamblese se ortakeve.
- Miraton lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtarash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme.
- Realizon blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te palujtshme te shoqerise ne perputhje me kriteret qe i jep ligji per shoqerite tregetare etj.
- Merr vendime te tjera ne dobi te veprimitarise tregetare.

### Neni 12

Marrja e vendimeve te Ortakeve regjistrohet ne regjistrin e vendimeve te ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

### Neni 13

#### **THIRRJA E ASAMBLESE**

Asambleja e Ortakeve nese shoqeria do te kete me shume se 1 (nje) ortak thirret sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se ortakeve thirret te pakten nje here ne vit. Asambleja e ortakeve thirret nga Administratori ose nga ortaku i cili perfaqeson te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene te Ortakeve te Shoqerise.

Asambleja e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkresje ose nepermjet postes elektronike 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese se ortakeve. Njoftimi ne te dyja format e mesiperme duhet te permbaje vandin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites.

## Neni 14

### ADMINISTRIMI

Shoqeria administrohet nga nje administrator i cili caktohet ne statutin e shoquerise nga Asambleja e Ortakeve. Administratori qendron ne detyre per nje periudhe jo me te gjate se 5 vjet me te drejte riperteritje kohore dhe ne rast se gjate kesaj periudhe shfaqen probleme paaftesie nga ana e tij, asambleja e ortakeve vendos shkarkimin e tij per shkaqe te arsyeshme.

Administratori detyrohet te kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoquerise duke zbatuar politikat tregetare te vendosura nga asambleja e ortakeve te shoquerise.

Ai kujdeset per mbajtjen sakte dhe te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoquerise. Ai pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor te shoquerise, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqesin keto dokumente para asamblese se ortakeve te shoquerise per miratim.

Ai ka kompetencat sipas ligjit me perjashtim te kompetencave qe ligji dhe Statuti i shoquerise jua jep shprehimisht Asamblese se Ortakeve te shoquerise. Administratori do te kryej vetem pagesat e taksave, tatimeve e detyrimeve te obligueshme ndaj shtetit ndersa per pjesen tjeter do te nevojitet autorizimi me shkrim nga Ortaket.

#### Administratori nuk mund te kryeje:

- Lenien peng ose ne hipoteke te pasurive te shoquerise;
- Shit-blerje te pasurive te paluajteshme ne pronesi te Shoquerise;
- Te kontrakoje ne çfaredo lloj forme qofte, te marri hua tek shoqeria, te japi pelqimin ne emer te saj per paradhenie si dhe te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve.

Administratori i shoquerise eshte **Z. Behadir Meta**, shtetas shqiptar, me numer personal J80314083P, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar. Ai do ta ushtroje kete detyre per nje periudhe 1 vjecare. Me te drejt rinovimi.



## Neni 15

### MARREDHENIET E PUNES

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjisacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respekoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe i shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit

## Neni 16

### KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla.

## Neni 17

### EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise i besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet nga Asambleja e Ortakeve. Ortaket percaktojnë edhe shperblimin perkates midis tyre si marredhenie dy paleshe.

## Neni 18

### VITI FINANCIAR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Viti finanziar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat lidhur me perllogaritjen e rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, mbasi eksperti kontabel t'i kete certifikuar ato si te verteta dhe te sinqerta atehere asambleja e ortakeve vendos se cfare do te bej me fitimin apo humbjen e shoqerise ne se do te ndahen si divident apo do te shtoj kapitalin e saj.



### **Neni 19**

### **SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye Ortaket percaktojne menyren e likuidimit, emerojne nje ose me teper likuidator dhe pergatisin te gjitha dokumentet e nevojshme per ç'regjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.

### **Neni 20**

### **ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin me interpretimin dhe/ose zbatimin e ketij Statuti do te zgjidhen me mirekuptim dhe do te diskutohen ne menyre te drejtperdrejte midis paleve te interesuara.

Ne rast se nuk do te arrihet nje zgjdhje me mirekuptim te mosmarreveshjes, ajo do ti besohet Gjykates se Rrethit Tiranë.

### **Neni 21**

### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr. 9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit ". Cdo ndryshim behet ne perputhje me kete Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie. Per cdo gje qe nuk eshte shprehur ne statut merret ne konsideratë ligji dhe aktet nen ligjore ne fuqi Statuti eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Tirane, me 16.06.2022

**ORTAKU I SHOQERISE**

**Z. FATOS XHEMAJLI**



